

LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR GJUHËT E PAKICAVE

1. Ngjarjet e përgjakshme që shoqëruan prishjen e perandorive komuniste të Evropës Lindore, treguan qartë se problemi i pakicave etnike, racore, fetare e kombëtare përbën sot një nga shqetësimet më të mëdha për bashkësinë ndërkombëtare, e cila po punon për zgjidhjen e tij sipas standardeve demokratike, duke punuar si për përmirësimin e kuadrit juridik, ashtu edhe për gjetjen e mekanizmave detyrues për ta bërë shumicën sunduese t'i zbatojë në praktikë ligjet për mbrojtjen e pakicave. Prandaj, me rënien e regjimeve totalitare, kujdesi i demokracive perëndimore u përqendrua sa në përpjekjet për krijimin e kulturës demokratike të qeverisjes në shoqëritë e reja pluraliste pasdiktatoriale, aq edhe në çështjen delikate të garantimit të të drejtave të grupeve të ndryshme minoritare.

Çështjet e të drejtave të pakicave u bënë për herë të parë objekt i kujdesit të bashkësisë ndërkombëtare qysh nga fundi i Luftës së Parë Botërore. Shembja e Perandorive Otomane, Austro-Hungareze e Ruse, në territoret e të cilave kishin ndodhur shpërngulje dhe lëvizje të shumta të popullsisë, ku me dhunë e ku vullnetare, dhe krijimi në territoret e tyre i një numri të madh shtetesh të reja me popullsi etnikisht johomogjene, nxori para Fuqive fituese nevojën e mbrojtjes së pakicave. Nën shtytjen e deklaratës prej 14 pikash të Presidentit amerikan U. Uilson për rendin e ri botëror, i cili kërkonte, ndër të tjera, edhe garantimin e të drejtave të individëve që u përkitnin pakicave, përfshirë edhe një autonomi më të madhe të këtyre, Konferenca e Paqes e Parisit e konsideroi respektimin e të drejtave të pakicave si kusht për ruajtjen e ekuilibrave dhe të paqes në botë. Në përputhje me propozimin e presidentit amerikan, kjo konferencë krijoi në maj të vitit 1919 një komision të quajtur Komisioni i Shteteve të Reja, i cili u ngarkua të përgatiste një varg projekttraktatesh për mbrojtjen e pakicave në shtetet e Evropës Lindore¹.

Mbrojtjen e pakicave nga politikat e asimilimit me dhunë Lidhja e Kombeve e quajti një nga detyrat e veta dhe shteteve të reja që kërkonin të bëheshin anëtare të saj, u vuri si kusht nënshkrimin e deklaratave për njohjen e pakicave racore ose kombëtare që përfshiheshin brenda kufijve të po atyre të drejtave që gëzonte edhe shumica sunduese. Një deklaratë të tillë Shqipëria e nënshkroi më 2 tetor 1921. Në këto deklarata, që hynin në grupin e traktateve lidhur me pakicat racore, fetare dhe gjuhësore, shteteve nënshkruese u kërkohesh të siguronin për pakicat: "(a) barazinë para ligjit, dmth. barazi të të drejtave civile dhe politike lidhur me pranimin në funksione publike; (b) përdorimin e lirë të gjuhës amtare në raportet private dhe në tregti, në çështje të besimit, në botimet dhe në mbledhjet publike si dhe para gjykatave; (c) të drejtën e përfitimit falas nga institucionet bamirëse, fetare e arsimore; (d) në distriktet ku pakicat përbënin një numër të konsiderueshëm të popullatës, mësimi në shkollat fillore të shtetit të jepej në gjuhën e pakicës dhe një pjesë e barabartë e buxhetit qendror e vendor për qëllime të edukimit, fetare e bamirësie t'u jepej pakicave."² Nga ana tjetër, ajo nxiti shtetet nënshkruese të traktateve të paqes, që të përfshinin në këto traktate edhe klauzola për shkëmbimin e pakicave, siç qenë ato midis Greqisë e Turqisë, Jugosllavisë e Turqisë etj., duke u nisur nga ideja se shkëmbimi i ndërsjellë i pakicave do të shpinte në shuarjen e konflikteve, ide në thelb e gabuar. Për të ndjekur respektimin e të drejtave të pakicave, Lidhja e Kombeve krijoi edhe një organizëm të veçantë gjyqësor, Gjykatën e Lartë të Drejtësisë Ndërkombëtare në Hagë.

Megjithatë, Lidhja e Kombeve nuk arriti që të kontrollonte dhe as të impononte zbatimin e parimeve të saj për mbrojtjen e pakicave. Si gjatë periudhës para Luftës së Dytë Botërore,

edhe gjatë saj, mbizotëroi ideja e krijimit të shteteve kombëtare etnikisht homogjene, e cila arriti kulmin me holokaustin nazist. U desh të kalonin dy-tre dhjetëvjeçarë, gjatë të cilëve u shemb sistemi kolonial në Azi e Afrikë, që të emancipoheshin mendjet e politikanëve perëndimorë dhe të braktiseshin një herë e përgjithmonë këto ide të gabuara që u sollën mjaft fatkeqësi popujve të botës, sidomos pakicave.

2. Legjislacioni ndërkombëtar i pasluftës për të drejtat e pakicave zë fill me "Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut" (1948) të OKB-së, e cila shpalli se "njohja dhe respektimi i dinjitetit të njeriut dhe i të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore përbën themelin e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes në botë"³. Neni dy i kësaj deklaratë, sipas të cilit "cilido duhet të gëzojë të gjitha të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, besimi, bindjet politike apo ndonjë opinion tjetër, nga origjina kombëtare ose shoqërore, nga pasuria, nga përkatësia prindërore apo ndonjë status tjetër" dhe neni 26, i cili kërkon që edukimi të ketë si objektiva, ndër të tjera, të nxitë "mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë mes gjithë kombeve, grupeve racore ose fetare"⁴, kanë shërbyer si bazë për konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e pakicave.

Në dokumentacionin e fazës së parë pas Luftës së Dytë Botërore, fazë që arrin deri aty nga viti mes i viteve '60, u mëshohet të drejtave të njeriut, kurse të drejtat e pakicave në to nuk përmenden. Në fazën që vjen më pas, në dokumentet ndërkombëtare fillojnë të zënë vend të drejtat e pakicave. Kjo e ka një shpjegim. Lënia jashtë vëmendjes e mbrojtjes së të drejtave të pakicave lidhet me brishtësinë dhe pafuqinë e institucioneve mbishtetërore (ndërkombëtare ose rajonale) për t'iu imponuar shteteve të veçanta, por edhe me frikën se imponimi mund të çonte në konflikte të tjera. Nga ana tjetër, vënia e theksit tek të drejtat themelore të njeriut do të thotë se ndërtimi i një shoqërie humane duhet të nisë nga themelet, nga individët e vetëdijshëm për të drejtat dhe liritë e tyre dhe pastaj të ngjitet tek organizimet e tyre shoqërore.

Duke ia lënë shqyrtimin e hollësishëm të dokumentacionit të OKB-së për të drejtat e pakicave specialistëve të fushës së të drejtave, në këtë punim do të ndalemi fare shkurt në dy nga dokumentet ndërkombëtare më të rëndësishme. Sipas radhës kronologjike, e para është "Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike" (1966), të cilën e ka nënshkruar edhe Shqipëria demokratike. Kjo Konventë, që u hartua me synimin e respektimit të të drejtave qytetare dhe politike, hedh një hap të rëndësishëm përpara në krahasim me Deklaratën Universale, duke i parë të drejtat e njeriut jo vetëm në planin individual, por edhe në planin kolektiv, si bashkësi.

Këto dhe dokumente të tjera të OKB-së për të drejtat e njeriut shtruan shkallë-shkallë rrugën për "Deklaratën mbi të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore", një nga dokumentet themlore të OKB-së për mbrojtjen e pakicave, që u miratua nga Asambleja e Përgjithshme në dhjetor 1992. E nisur nga bindja se "nxitja dhe mbrojtja e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore kontribuon në stabilitetin politik dhe social të shteteve ku jetojnë këto pakica dhe "në forcimin e miqësisë dhe të kooperimit midis popujve dhe shteteve"⁵, Deklarata në fjalë shpall si detyrim të shteteve nënshkruese mbrojtjen e pakicave nga çdo formë shtypjeje dhe asimilimi, pjesëmarrjen aktive të tyre në jetën e vendit të cilit i janë qytetarë dhe sigurimin e së drejtës për të zhvilluar kulturën e vet, për të ushtruar besimin e vet dhe për të përdorur në jetën private dhe publike gjuhën e vet⁶.

3. Krahas dhe paralelisht me dokumentet e OKB-së, në Evropë janë hartuar e miratuar nga OSBE-ja, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Europian një sërë konventash dhe dokumentesh për mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Një pjesë e tyre kanë një përmbajtje paralele me ato të OKB-së, kurse një pjesë tjetër burojnë nga veçanësitë europiane. Ndër to, dokumenti që ushtroi një ndikim të madh në zhvillimet politike të çerekut të fundit të shek. XX sidomos në Evropën Lindore, është Karta e Helsinkit e vitit 1975, e cila të drejtat e pakicave i ngriti në një stad më të lartë, duke i parë si pjesë të pandarë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në lidhje me respektimin e të drejtave të pakicave, në këtë Kartë të Konferencës së Helsinkit të organizuar nga OSBE-ja, deklarohet: "Shtetet pjesëmarrëse në territorin e të cilave ka pakica kombëtare, do të respektojnë të drejtat e individëve që u përkasin këtyre pakicave për të qenë të barabartë para ligjit, do t'u ofrojnë atyre mundësi të plota për të gëzuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në këtë mënyrë, do të mbrojnë interesat e tyre në këtë fushë"⁷ Një vend të veçantë në këtë dokument zë çështja e "pakicave kombëtare ose e kulturave rajonale", që përbën parimin e shtatë të tij, i cili kërkon nga shtetet pjesëmarrëse që, "duke ditur kontributin që pakicat kombëtare ose kulturat rajonale mund të sjellin në kooperimin mes këtyre shteteve në fusha të ndryshme të kulturës, të përqipen që, kur brenda territorit të tyre ka pakica ose kultura të tilla, të lehtësojnë përhapjen e tyre, duke marrë parasysh interesat legjitimë të anëtarëve të tyre"⁸. Nene të tjera të posaçme të Aktit konkretizojnë masat që duhen marrë për "mbrojtjen dhe krijimin e kushteve për nxitjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicave kombëtare" (neni 25).

Një hap të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të pakicave shënoi "Karta e Parisit për një Europë të re" (1990), e miratuar po nga OSBE-ja. Multikulturalizmin, që Akti i Helsinkit e cilëson si një nga vlerat themelore të Evropës, kjo Kartë e konsideron si një ndër përmasat njerëzore, duke theksuar vendosmërinë për të nxitur kontributin e pakicave kombëtare në jetën shoqërore europiane dhe duke u zotuar për ta përmirësuar edhe më shumë gjendjen e tyre. Ajo ripohon bindjen e thellë se marrëdhëniet miqësore mes popujve europianë, si dhe paqja, drejtësia, stabiliteti dhe demokracia "kërkojnë që të mbrohen identitetet etnike, kulturore, gjuhësore dhe fetare të pakicave kombëtare dhe të krijohen kushte për nxitjen e këtij identiteti"⁹.

Një hap të mëtejshëm përpara në mbrojtjen e të drejtave të pakicave shënon edhe "Dokumenti i mbledhjes së Kopenhagës mbi dimensionin njerëzor të OSBE" (qershor 1990), i cili prek një varg problemesh, si mosdiskriminimi, përdorimi i gjuhës amtare dhe mësimi i gjuhës amtare e në gjuhën amtare. Megjithëse nuk është një traktat, ky dokument pati një rëndësi të madhe politike dhe ligjore. Rëndësia e tij qëndron në gatishmërinë e shteteve pjesëmarrëse për të pranuar mbrojtjen që ai u bënte pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe të drejtat gjuhësore. Një tjetër dokument i rëndësishëm europian për të drejtat e pakicave është "Konventa-kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare" e Këshillit të Evropës, e miratuar më 1 shkurt 1995. Kjo konventë është dokumenti i parë modern gjithëeuropian që synon mbrojtjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe që përmban edhe një numër të konsiderueshëm nenesh për të drejtat gjuhësore. Ajo i konsideron mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe të drejtat dhe liritë e personave që u përkasin këtyre pakicave si pjesë përbërëse të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

4. U zgjatëm pak në legjislacionin ndërkombëtar dhe europian për të drejtat e pakicave, pasi, pa këto, nuk mund të kuptohen të drejtat gjuhësore të pakicave, të cilat janë pjesë përbërëse e tyre. Të drejtat gjuhësore zënë një vend themelor ndër të drejtat e pakicave, të tillë që, pa të drejtën e përdorimit të gjuhës, nuk mund të realizohen të drejtat kulturore, fetare etj.

Kjo shpjegohet me atë që gjuha është element themelor i kulturës, madje, në mjedisin e pakicave, ajo është mjete pothuajse i vetëm i shprehjes dhe i krijimit të kulturës së një etnie dhe, si rrjedhim, edhe tipari më i rëndësishëm që e dallon një pakicë nga shumica ose nga pakicat e tjera rrethuese.

Në legjislacionin ndërkombëtar dhe europian të periudhës para viteve '70, të drejtat gjuhësore të pakicave ose nuk figurojnë fare, ose vetëm sa përmenden, siç u pa nga citimet e sjella më sipër. Për herë të parë në legjislacionin e OKB-së të drejtat gjuhësore të pakicave përmenden në "Konventën ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike" (1966), neni 27 i së cilës kërkon që "në ato shtete që kanë pakica etnike, fetare ose gjuhësore, individëve që u përkasin këtyre pakicave, nuk u duhet mohuar e drejta që, së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të cilit i përkasin, të përdorin gjuhën e vet".

Ndër dokumentet e mëvonshme të OKB-së që u japin një vend më të madh të drejtave gjuhësore të pakicave, është "Deklarata mbi të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore" (1992). Nenet 2 dhe 4 të saj përmbajnë një varg pikash që lidhen me gjuhën. Kështu, neni 2.1 thotë: "personat që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore kanë të drejtën që të zhvillojnë kulturën e tyre, të besojnë dhe të praktikojnë fenë e tyre dhe të përdorin gjuhën e vet, privatisht dhe në publik, lirisht dhe pa ndonjë formë diskriminimi". Kurse neni 4 nxit shtetet që të marrin masat e duhura që personat të cilët u përkasin pakicave, t'i ushtrojnë plotësisht dhe në mënyrë efektive të drejtat njerëzore dhe liritë themelore, duke përfshirë zhvillimin e kulturës, të gjuhës, të besimit fetar, të traditave dhe të zakoneve. Për sa i përket gjuhës, nga shtetet kërkohet t'u krijojnë mundësi anëtarëve të pakicave të mësojnë gjuhën e tyre amtare dhe të mësohen në këtë gjuhë.

Mjaft vend i kushtohet çështjes së gjuhës së pakicave në Dokumentin e Mbledhjes së Kopenhagës. Nenet 3, 7 dhe 8 të tij trajtojnë çështje të tilla si e drejta e çdo personi që i përket një pakice të "zhvillojë në liri të plotë identitetin e vet fetar, etnik, gjuhësor ose kulturor" (neni 3.1); "të përdorë lirisht gjuhën e vet amtare, qoftë privatisht qoftë në publik, si me gojë ashtu edhe me shkrim" (neni 7.1); "të përdorë emrin dhe mbiemrin e vet në gjuhën amtare" dhe që "mbiemri dhe emri i tij t'i njihen zyrtarisht" (neni 7.2); në zonat ku banojnë një numër i konsiderueshëm personash të pakicës kombëtare, këta persona të kenë "të drejtë t'i shënojnë në gjuhën e tyre emrat, lokalitetet, shenjat, mbishkrimet dhe informacionin tjetër që mund të shikohet nga publiku" (neni 7.4); të mësojë gjuhën e vet amtare dhe të marrë arsim dhe kualifikim në gjuhën e vet amtare me një numër të mjaftueshëm shkollash dhe institucionesh arsimore, të vendosura në përputhje me shpërndarjen gjeografike të pakicës" (neni 8.1); "të hapin dhe të administrojnë shkollat e tyre si dhe institucionet arsimore dhe të kualifikimit brenda kuadrit të sistemit ligjor të shtetit" (neni 8.2)¹⁰.

Por dokumentet më të rëndësishme që u kushtohen plotësisht të drejtave gjuhësore, janë dy: "Karta uropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave (1995) dhe "Deklarata universale e të drejtave gjuhësore (1996).

"Karta Europiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave" u miratua nga Këshilli i Europës më 1992 në Strasburg dhe hyri në fuqi më 1995. Hartimi dhe miratimi i kësaj Karte u nxit nga qëllimi për të mbrojtur gjuhët rajonale ose të pakicave të Europës, disa prej të cilave të rrezikuara të zhduken. Duke i çmuar shumëgjuhësinë dhe multikulturalizmin si pasuri kulturore europiane e botërore dhe të vetëdijshëm se mbrojtja dhe nxitja e gjuhëve rajonale e minoritare në vendet e ndryshme të kontinentit "përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në ndërtimin e një Europe të mbështetur në parimet e demokracisë dhe të diversitetit kulturor"¹¹,

shumë shtete anëtare të Bashkimit Europian e kanë ratifikuar këtë dokument. Përmbajtja e Kartës është shumë e gjërë, duke filluar nga objektivat e parimet dhe deri tek mekanizmat detyrues për zbatimin e saj. Ajo përmban nene lidhur me edukimin në gjuhën e pakicës, përdorimin e saj në proceset gjyqësore, në administratë dhe në shërbimet publike, në mjetet e shkruara dhe elektronike të informimit, në verpimtaritë kulturore, në jetën ekonomike dhe shoqërore, në shkëmbimet kulturore ndërkufitare etj.

Deklarata Universale e të Drejtave Gjuhësore është fryt i përpjekjeve të një numri organizatash joqeveritare. Ajo u miratua më 6 qershor 1996 në Barcelonë nga 120 persona prej 90 shtetesh të ndryshme, që përfaqësonin rreth 100 organizata joqeveritare. Kjo deklaratë, që nuk ka fuqi detyruese, përmban 52 nene dhe një varg dispozitash shtesë, që rrokin një tematikë të gjërë të përdorimit të gjuhës së pakicave¹².

5. Para se të përqendrohemi në shqyrtimin e legjislacionit shqiptar për të drejtat gjuhësore, le të ndalemi shkurt në përbërjen etnike të Republikës së Shqipërisë. Për sa i përket përbërjes etnike, Republika e Shqipërisë¹³ nuk bën përjashtim nga modeli i përgjithshëm ballkanas. Në territorin e saj, përveç popullsisë autoktone, jetojnë edhe pakica, të cilat janë dy kategorish: pakica kombëtare, ku hyjnë pakicat greke dhe maqedone, dhe pakica etnike-gjuhësore, që përfshijnë arumunët dhe romët, të cilët nuk kanë shtet-komb amë. Megjithatë, Shqipëria politike dallon nga shtetet fqinje për një karakter më homogjen të popullsisë. Të mbështetur në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 1989, sipas të cilit pakicat përbënin vetëm 2% të popullsisë, në një studim tonin të mëparshëm, ne e kemi karakterizuar Shqipërinë si një shtet *endoglos*. Mirëpo, meqë regjistrimi i vitit 1989 kishte të dhëna vetëm për pakicat kombëtare, por jo për pakicat e llojit të dytë, del nevoja të bëhet një rektifikim i shifrave. Kjo bëhet edhe më e domosdoshme sot, kur Shqipëria është anëtare e Këshillit të Europës dhe ka nënshkruar një varg konventash europiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e pakicave. Në mungesë të të dhënave të reja zyrtare, jemi të detyruar t'u referohemi burimeve të huaja, të cilat janë jo aq të besueshme, pasi mbështeten në vlerësime e gjykime aprioristike¹⁴. Nga këto burime, do të marrim në shqyrtim ato të revistës elektronike "Ethnologue", që përmban të dhëna për gjendjen etnike dhe gjuhësore të shteteve, si dhe të dhënat e zyrës së Komisarit të Lartë të OKB-së për Pakicat lidhur me situatën gjuhësore të Shqipërisë¹⁵.

Përbërja etnike e Shqipërisë

Viti	Shqiptarë		Pakicat						
	Gjithsej	%	Gjithsej	Grekë	Maqedona s	Serbë dhe malazias	Arumunë	Romë	Kombës i të tjera
1989	3.117.600	98.0	64.816	58.758	4689	100	1261		
1991-5	3.521.000	93.9	214.816	64.816	30.000		60.000	60.000	
1994	3.500.000	92.3	230.000	60.000	30.000	20.000	20.000	100.000	

Edhe po t'i marrim si të vërteta shifrat e dy burimeve të fundit, për sa i përket raportit të popullsisë autoktone me atë aloktone, ndryshimi i tyre me regjistrimin e 1989-ës është shumë i vogël: mbi 90% e popullsisë flet gjuhën shqipe, pra kemi të bëjmë me një vend *endoglos*, gjë që pranohet edhe në raportin e zyrës së Komisarit të Lartë të OKB-së për të drejtat e njeriut, ku thuhet se Shqipëria "mbetet gjuhësisht një nga vendet më homogjene në botë"¹⁶

4. Edhe pse etnikisht dhe gjuhësisht Shqipëria politike është një vend homogjen, shteti shqiptar është ndeshur me problemin e pakicave që nga krijimi i tij e gjer më sot. Nënshkrimi më 1921 i deklaratës për respektimin e të drejtave të pakicave e vuri qeverinë shqiptare para detyrimesh ndaj Lidhjes së Kombeve dhe nën presionin e qeverive të shteteve fqinje, të cilat kërkonin të përfitonin sa më shumë të drejta për pakicat e tyre. Bilanci i përgjithshëm i përpjekjeve të shtetit shqiptar për respektimin e të drejtave të pakicave mund të thuhet se është pozitiv, shumë më pozitiv sesa ai i shteteve fqinje të Ballkanit.

Nuk po ndalemi në aspektet politike të trajtimit të pakicave, pasi shoqëria shqiptare njihet botërisht si një shembull pozitiv i bashkëjetesës së etnive të ndryshme, kështu që edhe shteti shqiptar, republikë, monarki apo diktaturë, nuk mund të impononte ndaj pakicave politika që binin ndesh me traditën kombëtare. Në fushën e të drejtave gjuhësore për të cilën jemi të interesuar, shteti shqiptar i sapokrijuar bëri përpjekje të sinqerta për të zbatuar detyrimet që rridhnin nga Deklarata e tetorit 1921. Me gjithë pastabilitetin politik të vendit, mungesën e legjislacionit, të përvojës dhe të mundësive materiale, në periudhën e paraluftës u bënë përpjekje të sinqerta për hapjen e shkollave publike edhe në fshatrat e banuara nga pakicat dhe arsimimin e fëmijëve minoritarë në gjuhën e vet amtare. Tregues i këtij kujdesi janë përpjekjet nga qendra në bazë për zgjidhjen e problemeve dhe ankesave të popullsisë minoritare, puna për hartimin e rregulloreve dhe të akteve nënligjore e ligjore lidhur me arsimin e pakicave.

Për gjithë këtë punë të nisur nga *ex nihilo* dëshmon dokumentacioni i pasur që ruhet në Arkivin Qendror Historik, në arkivin e Ministrisë së Jashmte dhe gjetkë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit arkivor të periudhës 1921-1939, del se qeverisë shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe drejtorive arsimore të prefekturave Gjirokastër, Vlorë, Korçë e Shkodër u është dashur të përballen me probleme nga më të ndryshmet lidhur me shkollimin e fëmijëve të pakicave dhe t'i kushtojnë një pjesë të mirë të përpjekjeve të tyre zgjidhjes së këtyre problemeve. Nuk duhet harruar se Shqipëria e pavaruar kishte dalë nga gërmadhat e një perandorie ku shumicës shqiptare i qenë mohuar të gjitha të drejtat, ku shqipja ishte një gjuhë e ndaluar, kurse greqishtja, gjuhë pakice në vendin tonë, gëzonte një status gati të njëjtë me turqishten. Para shpalljes së Pavarësisë, vetëm në prefekturën e Gjirokastrës numëroheshin rreth 130 shkolla greke, ndërkohë që shqipja mësohej në shtëpi. Kurse më 1927 numri i shkollave greke po në këtë prefekturë bie në 65, duke mbetur pa shkollë 29 fshatra minoritare, për shkak të numrit të vogël të banorëve të këtyre fshatrave, që, siç theksohet në një raport të kohës, nuk arrinin më shumë se 100-200 banorë. Por pa shkollë ishin edhe shumë fshatra shqiptare të prefekturës, me popullsi edhe më të madhe.

Vetëkuptohet se nën shtetin shqiptar anomalia e trashëguar nga sundimi otoman duhej të ndryshonte në të mirë të shqipes. Kjo gjë nuk mund të mos pritej me protesta nga pala greke, e cila donte të ruante privilegjet e hershme, aq më tepër po të shihen këto përpjekje në kontekstin e mëtimeve të Athinës zyrtare ndaj trojeve tona jugore dhe synimeve të saj për ekspansion kulturor në to. Në periudhën 1920-1939, në Shqipëri u hapën dhe funksionuan shumë shkolla të pakicave, laike dhe fetare. Numrin më të madh të tyre e përbënin shkollat greke, pastaj vinin shkollat bullgare, rumune, arumune dhe serbe. Në përputhje me strategjitë e veta, shtetet fqinje gjuha e të cilëve mësohej në Shqipëri, ushtronin trysni nga më të ndryshmet mbi qeverinë shqiptare për hapjen e shkollave të reja edhe atje ku nuk kishte pakica apo atje ku madhësia numerike e popullsisë minoritare nuk e përligjte hapjen e shkollës. Konsullatat greke, rumune, bullgare e serbe, veç trysnisë mbi autoritetet qendrore e vendore, i shoqëronin përpjekjet e tyre edhe me propagandë antishqiptare në fshatrat e

pakicave. Nga ana tjetër, edhe mësuesit e huaj të dërguar nga këto qeveri bënin, në kundërshtim me detyrën e tyre dhe me ligjin, propagandë të hapur antishqiptare.

E ndodhur përballë presionit gjithnjë në rritje për hapje shkollash private unike e të mesme, që shtonin rrezikun e indoktrinimit të pakicave me frymën e urrejtjes për shumicën autoktone, qeveria shqiptare e pa të domosdoshme hartimin e legjislacionit që do t'u priste rrugën këtyre dukurive dhe do të ruante fytyrën kombëtare dhe laike të shkollës shqipe. Për këtë arsye, në Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, që hyri në fuqi në vitin 1928, u futën nene që rregullonin me ligj hapjen e shkollave private. Të tilla ishin nenet 206 dhe 207:

"Art. 206. Arsimi fillor për të gjithë shtetasit shqiptarë është i detyruar dhe në shkollat e Shtetit jepet falas.

Art. 207. Në përputhje me ligjet dhe brenda parimeve të programit të pranuar prej shtetit për shkollat e veta dhe kurdoherë nën kontrollin efektiv të qeverisë, vetëm shtetasit shqiptarë mund të hapin shkolla të ndryshme private.

Të huajt, në përputhje me ligjet, mund të lejohen vetëm për shkolla teknike e bujqësore me programe teorike dhe praktike.

Gjithashtu, mund të hapen shkolla fetare me lejen e Ministrisë kompetente e konform ligjeve; numri i nevojshëm i shkollave fetare të çdo komuniteti, po ashtu edhe numri i nxënësve të këtyre shkollave caktohen prej Ministrisë përkatëse me vendimin e Këshillit Ministror."¹⁷

Në zbatim të kushtetutës, qeveritë shqiptare të kohës, të cilat në fillim kishin ndjekur politika tepër liberale, filluan të merrnin masa për kontrollimin e gjendjes, duke urdhëruar mbyllje shkollash private të hapura pa lejë, largim të mësuesve të huaj që bënin propagandë antishqiptare. Kështu, për të penguar propagandën antishqiptare të mësuesve të huaj të shkollave minoritare, qeveria shqiptare më 1928 mori masa për zëvendësimin e tyre me mësues shqiptarë¹⁸. Por duket se zbatimi i këtij vendimi hasi në vështirësi. Kjo del, ndër të tjera, nga një raport i gushtit 1932 i kryeinspektorisë së oborrit mbretëror mbi inspektimin e bërë në prefekturën e Gjirokastrës për shkollat e pakicave, ku theksohet se "është nevojë e madhe të emërohen sa më shumë mësues shqiptarë, të pajisur me cilësinë e atdhedashurisë dhe mësuesit grekofonë të mos lihen në shkollat grekofone, por të transferohen në shkollat shqipe dhe vendi i tyre të zëvendësohet me mësues thjesht shqiptarë"¹⁹. Nga ana tjetër, për të shmangur kaosin në planet mësimore, Ministria e Arsimit mori masa për mësimin në shkollat e pakicave edhe të gjuhës shqipe dhe rregullimin e raporteve të shqipes me gjuhën minoritare, duke i dhënë secilës gjuhë hapësirë të njëjtë. Këto politika ishin në përputhje me përpjekjet e shtetit për integrimin e pakicave në jetën politike, kulturore dhe ekonomike të shoqërisë shqiptare.

Ligji për mbylljen e shkollave private hasi në kundërshtimin e rreptë sidomos të qeverisë greke, e cila nuk la gur pa lëvizur për pengimin e zbatimit të tij. Agjencia greke filloi të nxiste popullsinë minoritare për të shkaktuar turbullira, u riaktivizua organizata famëkeqe e "Vorio-Epirit", iu drejtuan protesta nga banorët e pakicës greke Lidhjes së Kombeve²⁰. Qeveria greke, nga ana e vet, e paditi Shqipërinë në Gjyqin Ndërkombëtar të Drejtësisë në Hagë për shkelje të Deklaratës së vitit 1921 për mbrojtjen e pakicave. Gjyqi i Hagës e mori në shqyrtim këtë padi, që në literaturën juridike ndërkombëtare njihet si "Çështja e shkollave të pakicave në Shqipëri". Duke krahasuar përmbajtjen e neneve 206 dhe 207 të Statutit Themeltar me nenin 5 të Traktatit për pakicat e Shqipërisë, Gjykata arriti në përfundimin se ky nen "siguronte të drejtën e pakicave për të ngritur dhe mbajtur shkollat e veta private"²¹, kurse nenet 206 dhe 207 binin ndesh me zotimet e Shqipërisë për respektimin e të drejtave

gjuhësore të tyre. Në vendimin e saj të 6 prillit 1935 "Opinion këshillimor për shkollat e pakicave në Shqipëri", ajo deklaroi se "vendimi i qeverisë shqiptare prekte barazinë materiale të pakicave"²².

Duke i hedhur një vështrim përmbledhës periudhës së paraluftës, mund të thuhet se, në fushën e të drejtave gjuhësore të pakicave, Shqipëria ishte i vetmi shtet i Ballkanit ku pakicat u trajtuan në përputhje me legjislacionin e Lidhjes së Kombeve. Është e vërtetë se në Statutin Themeltar nuk flitet për to dhe kjo, e parë me syrin e sotëm, mund të gjykohet si një mangësi e legjislacionit shqiptar. Por, po të shihet ky problem në kontekstin historik dhe rajonal, del se Shqipëria nuk përbënte një përjashtim. Edhe pse nuk përmenden në mënyrë eksplicite në kushtetutë, pakicat gëzonin po ato të drejta civile dhe politike që kreu i gjashtë i Statutit Themeltar u njihte gjithë shtetasve shqiptarë, pa dallim përkatësie etnike.

Kësaj periudhe i përket një dokumentacion i pasur për të drejtat gjuhësore të pakicave, që përmbledh rregullore, udhëzime, vendime e statute, akte nënligjore e ligjore për shkollat e pakicave, të hartuara nga Ministria e Arsimit, Ministria e Oborrit Mbretëror dhe Kryeministria.

Pra, *de facto*, por edhe *de jure*, pakicat në Shqipëri gëzonin të gjitha të drejtat e parashikuara nga Traktati për Pakicat i Lidhjes së Kombeve. Dhe kjo ndodhte në një kohë kur popullsia shqiptare në Jugosllavi dhe në Greqi jo vetëm nuk gëzonte asnjë të drejtë, por u ishte nënshtruar politikave të asimilimit me dhunë, duke u përndjekur, duke u shpronësuar, duke u dëbuar nga trojet e veta dhe duke u shkëmbyer si popullsi turke etj.

7. Me mbarimin e Luftës II Botërore, Shqipëria u përfshi në bllokun komunist dhe vendin e monarkisë kushtetuese e zuri sistemi totalitar. Gjatë gjysmëshekullit të diktaturës çështja e të drejtave të pakicave u errësua nga problemi i madh i mohimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shtetasit shqiptarë, pa dallim përkatësie etnike, u privuan nga të gjitha të drejtat qytetare, ekonomike dhe politike: liria e fjalës, e lëvizjes, e drejta e pronës, e drejta e organizimit etj. Gjithë vendi iu nënshtrua logjikës barbare të luftës së klasave dhe praktikës shterpë të kolektivizimit.

Pra, të drejtat dhe liritë themelore iu mohuan si pakicës aloktone, edhe shumicës autoktone. Kështu që nuk i qëndrojnë së vërtetës pohimet se gjatë regjimit komunist pakicat u "getoizuan", se "56 mijë grekët u shpërndanë *manu militari* në 99 fshatra dhe disa mijëra maqedonas në shtatë fshatra të tjera"²³. Nuk qëndrojnë as pohimet e *qeverisë* greke se "400 mijë grekët qenë futur në këto "rezervate" ose "kampe" të ruajtura nga ushtria"²⁴.

Pas Çlirimit, shkollat private u mbyllën; u mbyllën gjithashtu edhe shkollat rumune e arumune, pasi e drejta e mësimin të gjuhës amtare iu njoh vetëm pakicave kombëtare, por jo pakicave etnike, si arumunëve dhe romëve. Në fshatrat e banuara nga pakica greke, maqedonobullgare dhe malaziase, raporti mes gjuhës shqipe dhe gjuhës amtare në shkollën fillore dhe 7- ose 8-vjeçare ishte në favor të shqipes.

Në dhjetëvjeçarët e parë pas Luftës, të drejtat arsimore dhe kulturore të pakicave rregulloheshin me akte nënligjore. Vetëm në Kushtetutën e vitit 1976 pakicat njihen *de jure*. Për to bëhet fjalë në dy nene të kësaj Kushtetute, nga të cilët neni 42 flet vetëm për pakicat kombëtare, por jo për pakicat etnike.

"Neni 40. Të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit.

Nuk njihet asnjë kufizim ose privilegj në të drejtat dhe detyrat e shtetasve për arsye seksi, race, kombësie, arsimit, pozite shoqërore a gjendjeje materiale.

Neni 42. Pakicave kombëtare u sigurohet mbrojtja e zhvillimi i kulturës dhe i traditave popullore, përdorimi i gjuhës amtare dhe mësimi i saj në shkollë, zhvillimi i barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

Çdo privilegj a pabarazi kombëtare dhe çdo veprim që shkel të drejtat e pakicave kombëtare është antikushtetues dhe dënohet sipas ligjit.²⁵

Në trajtimin e pakicave edhe diktatura nuk mund të mos ecte në vijën e traditës kombëtare. Provë e kësaj janë trajtimi i njëjtë në shkollimin e lartë i nxënësve minoritarë dhe në punësimin e të diplomuarve nga shkollat e mesme profesionale e të larta, si edhe përfaqësimi i minoritarëve në shkallët më të larta të hierarkisë partiake dhe shtetërore. Sigurisht, politika që u ndoq ndaj pakicave në vitet e diktaturës kishte si synim të fundit integrimin e shkallëshkallshëm të tyre, dmth. ishte një politikë asimilimi, por asimilim paqësor, jo me dhunë.

8. Shembja e regjimit totalitar dhe vendosja e sistemit pluralist më 1991, sollën një përmbysje në fushën e të drejtave edhe për pakicat. Zotimi i Shqipërisë demokratike për t'iu përmbajtur standardeve të përparuara europiane në hartimin e legjislacionit të saj gjen mishërim qysh në Dispozitat Kushtetuese të prillit 1991. Neni 4.1 i këtyre Dispozitave të drejtat themelore dhe liritë i shtrin edhe në pakicat, duke shpallur se "Republika e Shqipërisë njih dhe garanton të drejtat themelore dhe liritë e individit dhe të pakicave etnike të konsakruara në tekstet ndërkombëtare". Kurse neni 25 përjashton çdo lloj persekutimi të individëve për arsye të racës, gjuhës apo të përkatësisë etnike:

1) Të gjithë individët janë të barabartë përpara ligjit.

2) Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Por neni që prek më drejtpërdrejt çështjen e të drejtave gjuhësore, është neni 26, i cili thotë:

1) Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre.

2) Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.

Me Dispozitat Kushtetuese statusi i pakicave ngrihet në një shkallë të lartë. Për herë të parë garantohen të drejtat themelore dhe liritë jo vetëm të individit, por edhe të pakicave etnike. Për sa u përket të drejtave gjuhësore, e reja e kësaj kushtetute provizore është se fëmijëve minoritarë u njihet e drejta "të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare", që do të thotë se gjuha e tyre amtare do të përdoret edhe si mjet për përfitimin e njohurive të reja.

Pjesa e nenit 26 që ka të bëjë me gjuhën, rimerret edhe në "Ligjin për sistemin arsimor parauniversitar" (1995), neni 10 i të cilit shpall: "Personave që u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre brenda kuadrit të planeve dhe programeve mësimore."²⁶

Në përputhje me ligjin e mësipërm, plani mësimor për shkollat 8-vjeçare të pakicave përcakton që 63% e orëve mësimore javore të jepen në gjuhën amtare të fëmijës, raport që në klasat më të ulëta është rreth 80-95% në të mirë të gjuhës së tyre amtare²⁷.

Përmbajtja e ligjeve për të drejtat gjuhësore të pakicave është zbrërthyer edhe në një varg aktesh nënligjore, ku përfshihen vendime e udhëzime të Ministrisë së Arsimit dhe të Këshillit

të Ministrave për çeljen e njësive të shkollimit në gjuhën greke për fëmijët e kësaj pakice pranë shkollave 8-vjeçare të qyteteve Gjirokastër, Sarandë e Delvinë, për futjen e mësimin të gjuhës greke në disa shkolla të mesme të rretheve të mësipërme, për mësimin fakultativ të gjuhës amtare edhe në qendrat e banimit jashtë zonave minoritare etj.²⁸

Kushtetuta e vitit 1998 përmban një korpus më të plotë ligjesh për të drejtat gjuhësore të pakicave. Ajo "bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat" i konsideron si një nga bazat e shtetit (neni 3). Përveç një pjese ligjesh që janë të reja, pjesa tjetër e tyre janë përsëritje e ligjeve të vitit 1991. Të tilla janë nenet 18 dhe 20, që rimarrin pa asnjë ndryshim nenet 25 përkatësisht 26 të Dispozitive Kushtetuese.

Të reja në këtë Kushtetutë janë neni 28, sipas të cilit "kushdo të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet" (pika 1). Kurse neni 31 përcakton se "gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe (pika c).

9. Por tjetër gjë janë ligjet dhe tjetër gjë është zbatimi i tyre në praktikë. Pyetja që mund të shtrohet natyrshëm lidhur me këtë, është se si është *de facto* gjendja e të drejtave gjuhësore të pakicave në Shqipërinë demokratike. Përgjigjja që del nga shqyrtimi i politikave gjuhësore të shtetit shqiptar ndaj pakicave dhe i situatës konkrete në zonat e banuara nga këto pakica, ashtu siç u bë më sipër, është se, në përgjithësi, pakicat i gëzojnë të drejtat gjuhësore që përfitojnë nga legjislacioni ndërkombëtar dhe europian dhe që ua njeh legjislacioni shqiptar. Ky pohim yni përputhet jo vetëm me opinionin zyrtar të vendit, por edhe me vlerësimet e faktorit të jashtëm që është i ngarkuar me njohjen e standardeve të të drejtave të pakicave. Po, për të arritur tek një gjykim më i plotë dhe i drejtë për këtë problem, duhet ditur edhe mendimi i vetë palës së interesuar, dmth. i pakicave.

Ndër vlerësimet e faktorit të jashtëm, do të ndalemi në dy letrat e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për pakicat kombëtare drejtuar ministrit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë lidhur me të drejtat e pakicës greke në Shqipëri. Në letrën e parë, të 23 shtatorit 1993, Komisioneri i Lartë konsolidimin e sistemit demokratik në Shqipëri e vlerëson si garancinë më të mirë për interesat e pakicës greke. Ai u bën thirrje anëtarëve të kësaj pakice që të "pranojnë kufizimet që situata e rëndë ekonomike dhe financiare" imponojnë në mosrealizimin e "një numri kërkesash të tyre, sidomos në fushat e edukimit dhe të kulturës, që vende më të pasura nuk do ta kishin të vështirë t'i përmbushnin", por, nga ana tjetër të këmbëngulin që të mos vihen në pozita inferiore në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë²⁹.

Letra e dytë, e 14 nëntorit 1994, pasi jep vlerësimin e misionit të kryesuar nga Komisioneri i Lartë se në Jugun e Shqipërisë "nuk ka prova të tensioneve ndëretnike" dhe se anëtarët e etnive të ndryshme "jetojnë në harmoni me njëri-tjetrin", ndalet gjerësisht në çështjet e të drejtave gjuhësore të pakicës greke. Lidhur me politikën arsimore në fshatrat me popullsi kryesisht greke, letra konstaton se, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe vendimet e Qeverisë, në ciklin e ulët të 8-vjeçares mësimi bëhet në gjuhën greke, me përjashtim të lëndës së gjuhës shqipe dhe të këndimit, kurse në ciklin e lartë, veç gramatikës së shqipes dhe leximit, në shqip zhvillohen edhe këto lëndë: historia dhe gjeografia e Shqipërisë, njohuri për kushtetutën, matematika, fizika dhe kimia. Lidhur me këtë, komisioneri i Lartë shkruan: "Megjithëse ka disa që do të pëlqenin një rritje të numrit të lëndëve që jepen në gjuhën greke, ne krijuam përshtypjen se ky raport lëndësh, në përgjithësi, konsiderohet i pranueshëm nga anëtarët e pakicës greke, shumë prej të cilëve e kuptojnë se

është në të mirën e fëmijëve të tyre që, përveç edukimit në gjuhën e tyre amtare, të marrin njohuri të mjaftueshme për gjuhën e shumicës së vendit qytetarë të të cilit ata janë."

I vetmi shqetësim që ngre kjo letër, është problemi i shkollimit në zonat ku personat me kombësi greke nuk përbëjnë shumicën, por megjithatë janë në një numër të konsiderueshëm, si në qytetet e Gjirokastrës, Sarandës dhe Delvinës dhe në disa fshatra të tjera, problem që qysh atëherë ishte vënë në rrugën e zgjidhjes.

Me rëndësi për të gjykuar për gjendjen e të drejtave gjuhësore të pakicës greke është konkluzioni përfundimtar i Komisionerit të Lartë:

"Misioni ka arritur në konkluzionin se, në thelb, me Vendimin nr. 396 dhe Udhëzimin nr. 14, kërkesat lidhur me të drejtat arsimore të personave që u përkasin pakicave kombëtare të parashtruara nga Dokumenti i Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990 dhe standardet e tjera ndërkombëtare janë janë përmbushur. Personave që i përkasin pakicës greke, u janë dhënë mundësitë e duhura për mësimin e gjuhës së tyre amtare dhe personave që banojnë në fshatrat kryesisht greke ose që dëshirojnë të përdorin transportin urban falas për në shkollat e atyre fshatrave, u është dhënë gjithashtu mundësia të kenë mësim në gjuhën e tyre amtare në një numër lëndësh nga klasa e parë tek klasa e tetë. Në këtë mënyrë, asimilimi është parandaluar dhe pluralizmi është mbrojtur, ndërkohë që është e legjitimuar nga instrumentet ndërkombëtare të ndiqet një politikë e integritimit në shoqërinë e përbashkët"³⁰.

Për sa i përket qëndrimit të vetë pakicës greke lidhur me të drejtat e saj, vlen të përmendet deklarata e 5 majit 1993 e organizatës OMONIA, në të cilën vihet në dukje se, në kohën kur në Ballkan dhe në Evropë kanë shpërthyer konflikte të egra, shumica shqiptare dhe pakica greke "kanë treguar kulturën dhe maturinë e tyre dhe kanë ditur t'i zgjidhin problemet me të cilat janë përballur, me një frymë demokratike mirëkuptimi dhe me anë të dialogut e tolerancës"³¹.

9. Duke përfunduar, duhet vënë në dukje se në ndërtimin e politikave gjuhësore ndaj pakicave shteti shqiptar është mbështetur në një legjislacion të kohës, që është hartuar duke marrë parasysh legjislacionin ndërkombëtar dhe evropian për këto probleme. Më anë tjetër, qeveria shqiptare ka ratifikuar shumë nga traktatet dhe konventat ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e pakicave, si "Kartën evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave", "Konventën-kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare" të Këshillit të Europës, si dhe mjaft dokumente të tjera të OKB-së, të OSBE-së, të bashkimit Evropian etj.

¹ AQH, fondi 151, viti 1925, dosja nr. 139: Protection des minorités par la Société des Nations, p. 11.

² Po aty, p. 16.

³ Universal Declaration of the Human Rights, shih në Internet faqen e programit MOST të OSBE-së (OSCE).

⁴ Po aty.

⁵ Declaration Covenant on the Rights of Persons belonging to national or Ethnic Religious and Linguistic Minorities adopted by General Assembly, në "Human Rights 1945-1995", New York, 1995, p. 414.

⁶ Po aty, p. 414-420.

⁷ The Final Act of the 1st August 1975 of the Conference for Security and Co-operation in Europe, 1975 Summit, Helsinki, shih faqen e Internetit të programit MOST.

⁸ Helsinki Final Act (1 August 1975) CSCE, shih faqen e Internetit të programit MOST të OSCE (OSBE).

⁹ The Charter of Paris for a new Europe, shih faqen e Internetit të programit MOST.

¹⁰ Document of the Copenhagen Meeting of the Conference on the Human Dimension of the CSCE, shih faqen e Internetit të programit MOST.

¹¹ European Charter for Regional or Minority Languages, shih preambulën e teksit të nxjerrë nga faqja e programit MOST.

¹² Universal Declaration of Linguistic Rights, marrë nga faqja e Internetit e programit MOST.

¹³ Do të përdorim termat "Shqipëria politike" ose "Republika e Shqipërisë" për ta bërë të qartë se nuk po flasim për gjithë Shqipërinë si komb, po për shtetin shqiptar.

¹⁴ Kështu, në një studim të S. Schwander-Sievers për arumunët e Shqipërisë, për ta jepet shifra 200 mijë. Shih, S. Schwander-Sievers, *The Albanian Aromanian's Awakening: Identity Politics and Conflicts in Post-Communist Albania*, ECMI Working paper nr. 3, March 1999.

¹⁵ UNITED NATIONS HIGH COMMISSIONER FOR HUMAN RIGHTS. *The situation of the Greek ethnic minority in Albania: infringement of the rules for a fair trial*, Genève, 25 août 1994, sous-commission sur la prévention de la discrimination et la protection des minorités. Për pakicën greke ky burim pranon shifrën zyrtare, por përmend edhe mëtimin e qeverisë greke se në Shqipëri ka 280 mijë grekë. Shih në Internet faqen <http://www.unhchr.ch/html/menu4/subres/9412.htm>.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Statuti Theltar i Mbretërisë Shqiptare, Shtypshkronja "Mborthësia" Kristo P. Luarasi, 1928, ribotim, Tiranë, 1997, f. 35.

¹⁸ AQH, fondi 150, viti 1928, dosja 215.

¹⁹ Po aty.

²⁰ AQH, fondi 152, viti 1935, dosja 146.

²¹ F. De Varennes, *The Rights of Persons Belonging to Linguistic Minorities*, Murdoch University, Australia, 1997, shih në Internet faqen e programit MOST.

²² Dispute Concerning the Constitutionality of Certain Provisions of the School Education Bill of 1995, The Constitutional Court of South Africa, Case No Cct 39/95. Shih në Internet faqen e programit MOST.

²³ *The situation of the Greek ethnic minority in Albania: infringement of the rules for a fair trial*, Genève, 25 août 1994, UNITED NATIONS HIGH COMMISSIONER FOR HUMAN RIGHTS. Sous-commission sur la prévention de la discrimination et la protection des minorités.

²⁴ Po aty.

²⁵ Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1977, f. 25-26.

²⁶ Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 1995, nr. 15, f. 620-621.

²⁷ R. Memushaj, *Vështrim mbi dygjuhësinë në Shqipëri*. Studime albanologjike, 1977, nr. 2, f. 102.

²⁸ V. Bici, *Çështje të dygjuhësisë në shkollat e pakicave*, Tiranë, 2001, f. 18-19.

²⁹ Letter from the CSCE High Commissioner on National Minorities to the Minister of Foreign Affairs of Albania and the reply of the Minister of Foreign Affairs of Albania to this letter, Secretariat of the Conference on Security and Co-operation in Europe PRAGUE, CSCE Communication No. 251 + 251/Add.1, Prague, 23 September 1993.

³⁰ Letter of the CSCE High Commissioner on National Minorities to the Acting Minister for Foreign Affairs of the Republic of Albania, CSCE SECRETARIAT Department for Conference Services, CSCE Communication No. 35, Vienna, 14 November 1994.

³¹ Letter from the CSCE High Commissioner on National Minorities to the Minister of Foreign Affairs of Albania and the reply of the Minister of Foreign Affairs of Albania to this letter, Secretariat of the Conference on Security and Co-operation in Europe PRAGUE, CSCE Communication No. 251 + 251/Add.1, Prague, 23 September 1993.